

## ABSTRAKT

Prona paraqet një të drejtë ligjore subjektive, me efekt ergo omnes, që nënkupton se kjo e drejtë duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë edhe shtetin si garantuesin më të madh që kjo e drejtë përdoret, shfrytëzohet, disponohet dhe të mbrohet nga ndërhyrjet jo të drejta dhe diskriminuese. Pronësia si kategori ekonomike, është forma shoqërore e përvetësimit të mirave materiale nga njerëzit, e cila ka ekzistuar në çdo rend ekonomiko-shoqëror, që nga ai primitiv e deri më sot. Ndërsa pronësia si kategori juridike, shpreh sanksionimin e marrëdhënieve ekonomike të pronësisë nga ligji, e cila merr formën e marrëdhënies juridike të pronësisë. Pronësia është një e drejtë e transferueshme për të cilën duhet të ekzistojë një fakt juridik. Kalimi i së drejtës së pronësisë nga një person në tjetrin bëhet bazuar në vullnetin e lirë të pronarit, por në disa raste ajo mund të bëhet edhe pa vullnetin e pronarit, si me parashkrim fitues, nëse plotësohen kushtet e caktuara me ligj. Prona e paluajtshme, ka qenë dhe vazhdon të konsiderohet element bazik shtetformues. Si e tillë, ajo vazhdon të përbëjë një detyrim publik nga njëra anë lidhur me evidentimin dhe regjistrimin e saj dhe nga ana tjetër, një të drejtë private në aspektin e përfitimit. Pra në pronën e paluajtshme gërshetohen të drejtat dhe detyrimet private dhe publike.

Në procesin e fitimit të pronësisë mbi pronën e paluajtshme rol të rëndësishëm luan edhe procedurat teknike-ligjore e regjistrimit të pronës së paluajtshme. Shërbimi për regjistrimin e pronave në regjistrat kadastralë është i organizuar në Zyrat Kadastrale Komunale. E tërë veprimtaria është e bazuar në ligjet dhe udhëzimet administrative.

**Fjalët kyçe:** prona e paluajtshme, fitimi i pronësisë, parashkrimi, regjistrimi i pronësisë.